Kronikë

# Elbasan/ Qarkullonin me kallashnikov në bagazh, arrestohen 37-vjeçari dhe pasagjeri (VIDEO)

*Arrestimi i tyre ka ardhur si rezultat i operacionit "Covered".*

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
8 Shtator, 09:04 | **Përditesimi: 8 Shtator, 09:23**

Share

Është arrestuar 37-vjeçari Afrim Zhuka dhe 32-vjeçari Armand Kurti, të dy banues në Berat, pasi në bagazhin e automjetit që Zhuka drejtonte kishin fshehur një kallashnikov dhe municion luftarak.

Pasagjeri, Armand Kurti është vënë në pranga për "Moskallëzim krimi", ndërsa 37-vjeçari për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".

LEXO EDHE:
**Dimal/ Nxënësit e Goriçanit e Donofrosës mësim në lokale! Dy shkolla të shembura nga tërmeti nuk janë rindërtuar**

Arrestimi i tyre ka ardhur si rezultat i operacionit "Covered", ku Specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve, në bashkëpunim me shërbimet e Forcës Operacionale të DVP Elbasan në lagjen "Valas", Cërrik

Gjatë kontrollit në automjetin e Zhukës shërbimet e Policisë gjetën një armë zjarri kallashnikov dhe një sasi municioni luftarak, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për veprime të mëtejshme.

B.K/Shqiptarja.com

TAG: Armand Kurti | Afrim Zhuka | armembajtje pa leje | kallashnikov | Berat | Valas | Elbasan

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**Sipas jush PD përfundimisht po shkon drejt:**

Ndarjes | Bashkimit | Nuk e di

## Lajme të tjera

**VIDEO/ Fshehu në oborrin e banesës 3 armë zjarri dhe një gjahu, arrestohet 61-vjeçari në Fier**
6 Shtator, 11:14

**Kallashnikov dhe municion luftarak në banesë, arrestohet 50-vjeçari në Berat! I dënuar më parë për armëmbajtje pa leje**
6 Shtator, 10:38

**Fshihnin të ardhurat nga shitja e druve dhe kishin punonjës të paregjistruar, nën hetim administratorët e dy subjekteve në Librazhd**
6 Shtator, 08:42

**Në Berat e Durrës, Vjosa Osmani mbyll vizitën në Shqipëri! Presidentja nderohet me titullin 'Patron i Kalasë'! I dorëzon Ismail Kadaresë nënshtetësinë e Kosovës**
5 Shtator, 14:59

**Hodhi cigaren e ndezur dhe dogji tokat e mbjella të 2 personave, arrestohet 43-vjeçari në Cërrik**
5 Shtator, 13:37

**Kultivuan 980 rrënjë kanabis në malin e Tomorit, dy në pranga! Në hetim kryeplaku dhe inspektori i pyjeve në fshatin Novaj**
5 Shtator, 09:54

**Vodhi në bashkëpunim me një tjetër para në një biznes në Himarë, arrestohet 28-vjeçari në Elbasan**
4 Shtator, 11:18

**Akuzohen për krime zgjedhore e falsifikim dokumentesh, Gjykata e Elbasanit liron nga qelia shefin e zjarrfikëses së Cërrikut dhe 4 zyrtarët e tjerë**
3 Shtator, 17:06

**Ndezi zjarr në tokën e tij, flakët u përhapën dhe dogjën një sipërfaqe me shkurre! Nën hetim 41-vjeçari në Elbasan**
3 Shtator, 11:19

**Aksident me vdekje në aksin Elbasan-Tiranë, shoferi në gjendje të dehur përplaset me një mjet, ndërron jetë pasagjerja! Aksidentohen dy makina në Korçë (VIDEO)**
3 Shtator, 07:10

**Belsh/ 80-vjeçari humb kontaktet me familjarët prej 3 ditësh, dyshohet se është mbytur në lumin Devoll**
2 Shtator, 19:20

**'Një gur themeli i historisë së arsimit, gjuhës dhe kulturës shqiptare', sot 114 vjetori i Kongresit të Elbasanit**
2 Shtator, 15:24



© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje